



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Komuna - Municipality

Hani i Elezit



02/ Nr. 7384 /2021  
Data: 24.09.2021

## DEBAT PULBIK

I mbajtur me datë 17.09.2021 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 14:00, prezent ishin 11 qytetarë të komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. **Qamush Brava**.

### RENDI I PUNËS

1. Projekt-Buxheti për vitin 2022 dhe parashikimet për vitet 2022-2024
2. Projekt-Plani Vjetor i punës së kuvendit të Komunës për vitin 2022.

#### 1. Projekt-Buxheti për vitin 2022 dhe parashikimet për vitet 2022-2024

**Qamush Brava:** sa i përket kësaj pike siç jeni te njoftuar buxheti për vitin 2024 është në shumë prej 2,759,758.00 €.

Buxheti paraqet një pikë shumë të rëndësishme sidomos për Kuvendin e Komunës, zakonisht buxheti i propozuar reflekton kryesisht kërkesat e qytetarëve siç paraqiten gjatë dëgjimeve buxhetore të organizuar nga ekzekutivi, dëgjimet buxhetore nga ekzekutivi i kemi kryer do me thënë muajin e kaluar.

Unë do t'i paraqes vetëm kategoritë se ku shpenzohen, ndërsa Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Shabi Rexhallari na e laboron në detaje më vonë.

Sa i përket shpenzimeve shumica e shpenzimeve shkojnë në Paga dhe shtesa 63%, Mallra dhe Shërbime 14%, Shpenzime Komunale 2.45%, Subvencione transfere 2,9% dhe Shpenzime Kapitale 17%.

Zakonisht në këto tubime kontributin më të madh mundeni me e dhënë te projektet kapitale sepse propozimet e juve edhe në dëgjimet publike te ekzekutivit, edhe dëgjimit publik sot që e kemi do me thënë, qëllimi jonë është që propozimet e juve me u përfshirë te shpenzimet kapitale, e keni listën përpara ata janë propozimet e ekzekutivit kemi marrë edhe propozimet e qytetarëve që i kemi organizuar nga ekzekutivi në fshatra dhe në qytet, mirëpo tani në final i kemi edhe propozimet e juve sot që do ti marrë dhe pastaj me 30.09.2021 kur të miratohet buxheti çdo propozim veç e veç ne e shohim edhe e kalojmë.

**Shabi Rexhallari:** sa i përket Projekt- Buxhetit për vitin 2022 dhe parashikimet për vitet 2023-2024, meqenëse veç deri tani i kemi pasur 5 takime publike që janë mbajtur në fshatra dhe në Han të Elezit ekzekutivi, meqenëse në kuadër të ekzekutivit ka qenë edhe Kryesuesi i Kuvendit

Komunal z.Qamush Brava që ka marrë pjesë. Ne si bord i drejtorëve veç e kemi bërë përgatitjen edhe ia kemi dorëzuar Kuvendit komunal me datën 01.09.2021, po ashtu edhe propozimet që kanë dalur nga debatet publike, tani vetëm kryesuesi e ka pasur në bazë të ligjit të financave me e bërë një ftesë për takim edhe ky takim është dita e sodit që pas kësaj me propozimet sot që do të merren në këtë takim do ti bashkëngjitet tjerave për me u miratuar në Kuvend.

Sa i përket buxhetit të planifikuar për vitin 2022 sipas Qarkoreve buxhetore që e lëshon Ministria e Financave me kufijtë buxhetore final do të jetë në shumë prej 2,759,758€, ku ky buxhet ndahet në 4 financime, ku ato burime të financimeve do të jenë Granti i përgjithshëm që do të jetë në shumë prej 1,112,582€, pastaj Granti specifik vetëm për Arsim në shumë prej 939,957.00€, Granti për Shëndetësi 325,871.00€, dhe të hyrat vetanake 381,347.00€. Nëse i mbledhim të 3 Grantet financimi do të jetë 2,378.411€ apo 86.18%, ndërsa të hyrat vetanake 381,347.00€ apo 13.82% që këto të hyra mblidhen nga taksapaguesit, qoftë tatimi në pronë bizneset apo të hyrat tjera.

Nëse e marrim krahasimin në mes buxhetit 2022 dhe buxhetit 2021, pra do të ketë një rritje për 9.51 % apo 239,592.00€.

Për vitin 2023 buxheti do të jetë 2.903,855.00€ apo 5.22%, dhe për vitin 2024 do të jetë 3,039.398.00€ apo 4.67% rritje. Pra ky buxhet i vitit 2022 shpërndahet sipas kategorive ekonomike dhe kategoria me e madhe do të jetë në Paga dhe shtesa, ku për 239 të punësuar kostoja do të jetë 1,756.083.00€ apo 63.63%, Mallra dhe shërbime 385.375.00€ apo 14%, Shpenzime komunale 67,700.00€ apo 2.45%, Subvencione dhe Transfere 80.000.00€ apo 2.9%, dhe Investime kapitale do të jenë 470,000.00€ apo 17%, ndërsa në vitin 2023 te Investimet do të jenë 584,048.00 € dhe vitin 2024 do të jenë 697,114.00 €.

**Lutfi Meliqi:** te financimi i investimeve kapitale komunale 2022-2024 këtu unë e pash që nuk qenka e shënuar lagja ime askund, unë kisha propozuar që të futet në projekt edhe dy propozimet e mia rruga te varrezat e fshatit Meliq, edhe rruga prej te xhamia deri te varrezat e Puset e Nikës me u shtruar me kubëza betoni.

**Tahir Curri:** te fshati Dermjak vetëm rregullimin e kanalizimit po e shoh qe e keni futur në projekt, ndërsa rruga nuk qenka, ne rrugë nuk kemi dhe kërkesat e mia kanë qenë që 4vjet që rruga te ujësjellësi me u rregulluar dhe kisha propozuar qe kjo rrugë të futet në projekt.

**Visar Hasallari:** unë kisha propozuar me e bërë një Fushë Sportive për të rinjtë, sepse nuk po kemi, ku me luajtur edhe Ndërtimin e një salle në ambientet e hapura.

Te gjelbërimi i hapësirave publike është mirë qe me e gjetur një kompani digjitale qe na i bën disa reklama që Hanin e Elezit me e fokusuar në Turizmin malor.

## **2.Projekt-Plani Vjetor i punës se kuvendit te Komunës për vitin 2022.**

**Qamush Brava:** sa i përket kësaj pike me ligjin për qeverisje lokale, aty potencohet që për 6 mujorin e parë me u mbajtur 5 mbledhje, po ashtu edhe të dytin 5 gjithsej 10 për 1 vit, por unë zakonisht për 1 vjet i mbaj 12 mbledhje me kërkesë të këshilltarëve, edhe procedura e planit të punës së kuvendit shkon përmes kryesuesit, unë e kam formuar edhe një grup punues, ku në atë grup e kam propozuar një plan qe e keni përpara, kështu që nëse keni ndonjë propozim për ndonjë pikë me e futur do të kishte qenë mirë prej juve pastaj e kam edhe një takim me

ekzekutivin edhe legjislativin i marrë edhe propozimet e tjera edhe pastaj me datën 30.09.2021 miratohet.

**Visar Hasallari:** te puna e administratorëve të fshatrave unë kisha propozuar që vitin e ardhshëm që administratori i fshatit apo i lagjes që ka me qenë mos me pasur post politik sepse un nuk ndihem i sigurt nëse është një pjesëtar i partive politike.

**Lutfi Huneli:** Unë e kam një kërkesë kisha propozuar që përmes organizatave nëse kanë ndonjë projekt afër xhamisë së fshatit Meliq fëmijëve me ia bërë një fushë të futbollit, por nëse nuk ka projekt atëherë propozojë një fushë të vogël sportive.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

**Procesmbajtësi**  
**Ibrahim Axhami**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



TAKIMI KONSULLTATIV LIDHUR ME PROJEKTIN BUXHETIN PËR VITIN 2022 SI  
DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2023-2024 PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT  
TE THIRRUR NGA KRYESUESI I KUVENDIT

ORA: 14:00

VENDI: HANI I ELEZIT

DATA: 17.09.2021

NR	EMRI DHE MBIEMRI	NR. TELEFONIT	NENSHKRIMI
1	LUTFI MALIQI	044/850 227	<i>[Signature]</i>
2	AVDUSH IBRAHIMALI	044 867-849	<i>[Signature]</i>
3	ZAHIR CURRI	045 945 397	<i>[Signature]</i>
4	Visar Shasallari	044-819-392	<i>[Signature]</i>
5	Rozmi Cejani	04-137-159	<i>[Signature]</i>
6	Agam Doci	044-368-051	<i>[Signature]</i>
7	MEHMET VLASHI	044 225 129	<i>[Signature]</i>
8	Shali Rexhalla	044-573-325	<i>[Signature]</i>
9	IBRAHIM AXHAMI	045-255-420	<i>[Signature]</i>
10	Vait Daci	044-225 471	<i>[Signature]</i>
11	Armi Bushi	044-408-955	<i>[Signature]</i>
12	XHEVOET BUSHI	044-253-050	<i>[Signature]</i>
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			